

Emigrantët shqiptarë në Greqi

(Raste të keqtrajtimit të tyre nga policia greke)¹

¹ Ky raport është mbështetur në rastet e denoncuara nga GHM dhe Amnesty International, si edhe nga rastet e trajtuara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Përmajtja e lëndës:

Hyrje

Problematika e emigrantëve shqiptarë në Greqi

Rastet më tipike të keqtrajtimit të shqiptarëve

Dëbimet masive të emigrantëve shqiptarë

Rrahje dhe veprime të tjera dhune

Ushtrimi i dhunës ndaj grave dhe fëmijëve

Plagosje e lehtë dhe e rëndë me dashje

Vepra penale kundër jetës

Roli i Komitetit Shqiptar të Helsinkit në mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve shqiptarë

Përfundime dhe sugjerime

Hyrje

1. Historia shqiptare e dhjetëvjeçarit të fundit është e lidhur në mënyrë të ngushtë me emigracionin, kryesisht atë ekonomik. Pas proceseve demokratike të viteve '90, mungesa e një strategjie konkrete, si dhe mosvlerësimi real i pasojave të këtij fenomeni, çuan në mosmarrjen e masave efikase në drejtim të parandalimit të tij. Për pasojë nga vitet '91 e në vazhdim, emigracioni mori përmasa të gjera. Eksodet masive të shqiptarëve në drejtim të Italisë të cilat u shoqëruan me një sërë tragjesh që çuan në humbjen e jetëve njerëzore si ajo e Otrantos, ende vazhdojnë të përbëjnë një aspekt të hidhur të së kaluarës mbi emigracionin.
2. Më qëllim parandalimin e fenomeneve të tilla si dhe plotësimin e angazhimeve të ndërmarra në nivel ndërkombëtar nga shteti shqiptar, u morën masa të rrepta për kontrollin e rrugëve detare të trafikut. Në këto kushte, destinacioni i shumicës së emigrantëve shqiptarë u bë Greqia. Emigracioni drejt shtetit grek, i favorizuar edhe nga kushtet gjeografike e bën mjaft të vështirë vënien nën kontroll të plotë të kufijve. Shumë emigrantë shqiptarë të paligjshëm kabjnë kufirin nëpërmjet maleve.
3. Kjo plagë e shoqërisë shqiptare, jo në pak raste është shoqëruar edhe me fenomene negative që lidhen me mungesën e një trajtimi të përshtatshëm për emigrantet shqiptarë. Përmendim "operacionet fshesë" të ndërmarra nga policia greke që lidhen me dëbimet masive të emigrantëve shqiptarë nga territori grek. Këto operacione shpeshherë kanë shërbyer si mjet për të fshehur mungesën e një politike të mirëfilltë emigracioni ose edhe të parandalimit të kriminalitetit nga qeveria greke. Në raste të tilla janë vënë re çënime të të drejtave dhe lirive themelore të emigrantëve shqiptarë. Por jo të gjitha rastet e shkeljeve të të drejtave të tyre janë bërë publike ose janë rivendosur.
4. Rastet më të rënda të shkeljes së të drejtave janë përdorimi i dhunës së ushtruar mbi shqiptarët që jetojnë e punojnë në Greqi me ose pa dokumenta të rregullta. Përveç dhunës fizike nuk kanë munguar as rastet e shfaqjes së dhunës psikologjike. Midis rasteve të dokumentuara ka edhe incidente që përshijnë përdorimin e armëve madje në disa raste, edhe fatale nga ana e forcave policore greke ndaj shqiptarëve që tentojnë të kalojnë kufirin në mënyrë klandestine. Përdorimi i armëve në këto incidente bie në kundërshtim me standardet ndërkombëtare që e limitojnë përdorimin e tyre vetëm në raste të kërcënimit për jetën ose dëmtimit serioz, ose kur mjetet e tjera janë të pamjaftueshme.

Disa nga shkeljet e të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Greqi

5. Për një kohë të gjatë keqtrajtimi i emigrantëve shqiptarë nga policia greke ka qënë një shqetësim serioz. Lidhur me këtë çështje, në një konferencë për shtyp, Ombudsmani gek ka pohuar se "policia greke nuk i respekton si duhet masat disiplinore dhe në shumë raste ka ushtruar dhunë jo vetëm mbi shqiptarët por edhe mbi shtetas të tjerë"².
6. Nisur nga rastet e dënoncuara pranë KSHH-së, rezulton se pjesa më e madhe e keqtrajtimit të emigrantëve ka ndodhur në pikat e kalim-kufirit Kapshticë. Lidhur me këtë mund të themi se edhe numri më i madh i emigrantëve që kalojnë kufirin në mënyrë klandestine është regjistruar në këtë pikë.
7. Shkelje të të drejtave të njeriut ka patur edhe në marrëdhëniet e punësimit, në proceset gjyqësore, etj. Ka patur raste të dëmtimeve serioze të punëtorëve shqiptarë si pasojë e

² Gazeta "Panorama", datë 19.03.2005

kushteve jo të mira të punës, gjymtimit, raste të vdekjes së tyre për shkak të aksidenteve në punë, etj.

8. Shkelje të të drejtave janë vënë re në zhvillimin e proceseve gjyqësore ndaj shqiptarëve. Në ankesat e tyre, emigrantët shqiptarë në kontakt me drejtësinë greke, kanë pretenduar për çënime të rënda të të drejtave të tyre si: mungesa e një përkthyesi, dënime të larta në krahasim me shtetasit grekë, pretendimet për për njëanshmëri dhe shprehje të ksenofobisë³.
9. Në adresë të KSHH-së kanë ardhur në mënyrë të vazhdueshme ankesa nga shtetas shqiptarë të dënuar në Greqi që vuajnë dënimin në burgjet greke, ose që janë ekstraduar në Shqipëri. Gjatë periudhës 2000-2005 në adresë të KSHH-së kanë ardhur rreth 21 ankesa me shkrim dhe shumë telefonata nga të dënuar që ndodhen në burgjet greke. Objekti i tyre ka qenë:
 - **Mosnjohja e ditëve të punës në burgjet greke në konvertimin e dënimit nga gjykatat shqiptare.** Në fakt KShH-ja ka qenë në pamundësi për të verifikuar pretendimet e tyre. Nga ana tjetër, në momentin kur të dënuarit shqiptarë kanë kërkuar të transferohen, ligji kërkon që ditët e punës të jenë konvertuar nga gjykatat greke, para transferimit të dosjes së tyre në Ministrinë e Drejtësisë Shqiptare. Në rastet kur personat e transferuar i janë drejtuar gjykatave shqiptare, shumë prej tyre kanë pretenduar se nuk i janë njohur ditët e punës.
 - **Shkelja e të drejtave të njeriut në proceset gjyqësore të zhvilluara në Greqi.** Në ankesat e ardhura është pretenduar për procese gjyqësore me nota diskriminuese dhe në të cilat në disa raste nuk ka patur përkthim në gjuhën shqipe;
 - **Dhënia e dënimeve në një masë më të madhe se sa parashikon le gjisilacioni shqiptar për të njejtën vepër penale.** Në këtë kuadër ata pretendojnë për një mungesë të përjasjes së vendimeve gjyqësore greke me legjisllacionin shqiptar;
 - **Ka patur raste edhe kur shtetasit shqiptarë të dënuar në Greqi kanë kërkuar ekstradimin në Shqipëri dhe duke mos marrë përgjigje në kohë kanë kërkuar ndërhyrjen e KSHH-së pranë autoriteteve shtetërore.**
 - **Shunë të dënuar të transferuar dhe kontaktuar nga përfaqësues të KShh-së ka pretenduar se masa e dënimit ndaj shqiptarëve është shumë herë më e madhe se masa e dënimit që zbatohet ndaj shtetasve greke që kryejnë të njejtën vepër penale .**
10. Megjithë përvojën negative të paraqitur sheshherë nga emigrantët shqiptarë, nuk mund të mos përmendim një nga rastet e fundit, ku gjykata greke zbatoi një dënim të rëndë ndaj shtetasit grek që qëlloi për vdekje të riun 18-vjeçar, Vullnet Bytyçi më 22 Tetor 2003.
11. Krahas problemeve të konstatuara në trajtimin e emigrantëve shqiptarë, nuk mungojnë edhe përvojat pozitive. Angazhimi i shtetit grek është shfaqur në disa fusha, që kanë të bëjnë me lëvizjen e emigrantëve. Vetë pranimi i fenomeneve të tilla si keqtrajtim, shkelja e të drejtave të emigrantëve në proceset gjyqësore, etj, janë tregues për ndërgjegjësim dhe dëshirë për të ndryshuar pozitivisht. Nga ana tjetër, realiteti i jetës së emigrantëve shqiptarë sjell edhe

³ Raste të tilla nuk janë trajtuar në këtë raport, pasi janë mjetet gjyqësore ato që vendosin nëse një e drejtë është shkelur dhe rivënien në vend të saj.

shumë shembuj pozitivë të ndihmës që u është dhënë atyre, e cila ka qenë mjekësore, sociale, etj, ashtu edhe në përpjekjet që janë bërë për integrimin sa më të mirë të tyre pjesën tjetër të popullsisë.

Rastet më tipike të keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë në Greqi

12. Nga një analizë e ankesave të vetë emigrantëve si dhe vëzhgimeve të kryera nga KSHH në pikat kufitare të kalimit ka rezultuar se pjesa më e madhe e emigrantëve të keqtrajtuar janë nga zonat rurale. Kjo shpjegohet me faktin se pjesa më e madhe e shqiptareve që detyrohen të emigrojnë janë banorë të këtyre zonave. Vështirësitë ekonomike, papunësia, mungesa e strategjive shtetërore në ndihmë të ekonomive bujqësore i kanë çuar banorët e këtyre zonave drejt zgjedhjes së emigrimit.
13. Pjesa më e madhe e emigrantëve të keqtrajtuar i përkasin moshës 26-40 vjeçare. Mes tyre ka një numër të konsiderueshëm emigrantësh të grupmoshës 18-26 vjeçare. Kjo shpjegohet me faktin se për shumë familje shqiptare, meshkujt ë aftë për punë ose kryefamiljarët, tentojnë të emigrojnë në çdo mënyrë, duke përfshirë edhe kalimin në mënyrë të paligjshme të kufirit për të siguruar bazën ekonomike për familjen
14. Nga të dhënat e mbledhura nga KSHH, kryesisht për periudhën 2000-2005, kanë rezultuar shkelje të të drejtave të ndryshme dhe të kryera në forma të ndryshme të cilat në shumicën e rasteve kanë sjellë si pasojë cënimin e integritetit fizik e moral të emigrantëve shqiptarë madje në disa raste edhe me pasojë fatale për jetën.
15. Në 26.07.2001 autoritetet kufitare hapin zjarr ndaj një gomoneje që transportonte shqiptarë klandestinë me pasojë plagosjen e katër prej tyre nga të cilët dy ishin femra. Pretendimi i autoriteteve greke se shkak për këtë incident ishte hapja e zjarrit nga pasagjerët me një pushkë Ak 47 është mohuar nga pasagjerët shqiptarë të cilët në kthimin e tyre në Shqipëri mohuan të kishte patur armë në bord. Akuza penale ndaj rojeve greke u pushua nga Gjykata me vendimin 91/2002.

Dëbimet masive të emigrantëve shqiptarë

16. Të shumta kanë qenë rastet e kthimeve masive të emigrantëve shqiptarë që kanë hyrë në territorin grek në mënyrë klandestine. Kthimi i detyrueshëm i emigrantëve shqiptarë të cilët kanë hyrë në territorin grek në mënyrë klandestine e ka bazën në klauzolën e "ripranimit" e parashikuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Greqisë dhe Shqipërisë.
17. Vetëm gjatë datës 6 Prill 2005 në pikën kufitare të Kapshticës janë rikthyer rreth 140 emigrantë të paligjshëm. Kjo shifër është vetëm njëra nga shifrat rekord të shënuara në këtë pikë kufitare gjatë kësaj periudhe. Sipas burimeve të shtypit dhe të autoriteteve shqiptare, ky fenomen është pjesë e ritualit të kthimeve masive të emigrantëve shqiptarë që kapen pa dokumenta në thellësi të tokës greke.
18. Në pjesën më të madhe të rasteve dëbimet masive janë zbatuar madje edhe ndaj emigrantëve shqiptarë të cilët ndonëse pa dokumenta, jetojnë dhe punojnë prej kohësh në Greqi. Këto veprime mund të jenë bërë shkak edhe për akte tragjike si rasti i **F. D., 30 vjeç banues në Tepelenë**, i cili ka gjetur vdekjen duke u hedhur nga kati i katërt ku jetonte. Shkak është bërë ndalimi nga policia greke dhe vendimi për riatdhesimin e tij duke i hequr

të drejtën e kthimit për një periudhe 5-vjeçare. Ky veprim si dhe lënia e gjithë kursimeve në Greqi e kanë çuar 30 vjeçarit në depresion.

19. Nuk përjashtohen madje as rastet kur së bashku me emigrantët që nuk janë pajisur me dokumenta janë nxjerrë forcërisht jashtë territorit shqiptar edhe ata të pajisur me dokumenta të rregullta.
- **4-5 Shtator 2003, A.T. 35 vjeç banues në Gramsh** është goditur dhe fyer nga një oficer grek i pikës doganore Kapshticë me pretekstin se pasaporta ishte e fallsifikuar. Ai është sugjeruar të plotësonte një formular në gjuhën greke i përkuptueshëm për të dhe si pasojë e refuzimit është dëbuar nga territori grek. Sipas autoriteteve doganore të Korçës pasaporta ishte e rregullt.
 - Në 13 Nëntor të 2003, tetë persona janë rikthyer brenda 24 orëve nga kufiri grek me shenja keqtrajtimesh në trup. Midis tyre **Sh. Sh., 28 vjeç banues në Shegan të Lushnjës** është ndaluar nga policia megjithëse posedonte dokumenta të rregullta. Pas ndalimit, ndaj tij është ushtruar dhunë fizike, është goditur, rrahur dhe është mbajtur tre ditë në burg para transportimit të tij në zonën kufitare të Kapshticës ku ka bërë denoncimin.
 - **L. T. banues në Plug të Lushnjës**, ndonëse ka punuar prej tre vjetësh në Greqi dhe kishte dokumenta të rregullta, është marrë forcërisht dhe është vendosur në burg ku i është nënshtruar keqtrajtimit fizik. Ai është mbajtur në kushte çnjerëzore ku ushqimi mungonte dhe ambjenti ishte me lagështirë.

Rrahje dhe veprime të tjera dhune

- 20 Çështja më problematike në këtë drejtim është keqtrajtimi i emigrantëve shqiptarë përpara dëbimit të tyre forcërisht dhe në grup nga territori grek. Rastet e incidenteve kur emigrantët shqiptarë janë keqtrajtuar nga autoritetet policore kanë qenë mjaft të shpeshta. Në renditje kohore kronologjike disa nga rastet më tipike të ushtrimit të dhunës kanë qenë si më poshtë:
- **16 Nëntor 2000, K.Sh., 17 vjeç banues në Fshatin Frashtan të rrethit Fier**, është rrahur nga forcat policore greke. Për këtë çështje nuk është bërë asnjë hetim nga autoritetet greke.
 - **13 Qershor 2001, A.Ll. nga fshati Rukaj i rrethit të Burrelit, K. R. nga fshati Arrëz i rrethit të Mirditës dhe D. T. nga rrethi i Fierit** janë arrestuar nga rojet greke të kufirit ndërsa përpiqeshin të kalonin kufirin grek. Ata janë rrahur, iu janë marrë të hollat dhe gjithçka kishin me vete të cilat iu janë kthyer më vonë.
 - **28 Tetor 2002**, Komiteti Europian mbi Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor apo Degradues në raportin e tij të 31 mbi Greqinë ka përmendur dy raste të keqtrajtimit të shqiptarëve nga forcat policore. Dy të burgosur shqiptarë në rajonin e policisë së Igumenicës, të cilët sipas policisë greke ishin arrestuar në 28 shtator 2002 në afërsi të kufirit greko-shqiptar dhe akuzuar për kontrabandë droge, janë rrahur brutalisht nga policia. Njëri prej tyre u ankua se gjatë hetimeve ishte goditur në kurriz dhe në këmbë me një shkop gome çka u konfirmua edhe nga ekzaminimi mjeko-ligjor. I ndaluar tjetër u ankua gjithashtu se ishte goditur në shputat e këmbëve. Autoritetet greke u justifikuan me faktin se pretendimet e të keqtrajtuarve nuk përputheshin me hetimet që ishin ndërmarrë në lidhje me këtë çështje dhe asnjëri prej tyre nuk kishte bërë denoncim për keqtrajtim.

- **Korrik 2003, Lefter Kalivaci banues në fshatin Bistrovicë të rrethit Berat**, ka kaluar kufirin nëpërmjet pikës kufitare të Kakavijës. Ai pretendon se një punonjës i policisë greke i shoqëruar nga një civil i ka kërkuar para, ndonëse sipas pretendimeve të tij kishte dokumenta të rregullta. Më pas ai është vendosur në një qeli ku i është nënshtruar keqtrajtimit fizik nëpërmjet rrahjes deri në humbjen e ndjenjave. Pas kthimit në Shqipëri është mjekuar në spitalin e Elbasanit. Policia shqiptare nuk mori asnjë deklaratë të tij.
- **15 Shtator 2003, L. Ilko 29 vjeç nga fshati Hoshtë, i rrethit Pogradec, D. B, 26 vjeç nga Miras rrethi i Devollit, G. D., dhe L.K., kanë qënë viktime të keqtrajtimit fizik.** Rastet në fjalë kanë qënë në qendër të vëmendjes së organizatave ndërkombëtare si Amnesty International e cila e ka ngritur shqetësimin e saj tek autoritetet greke pa marrë asnjë përgjigje.
- **Nëntor 2003, Ilir Ura 23 vjeç nga fshati Shkafan i rrethit të Durrësit**, ka punuar në Greqi për një periudhë rreth 8 vjeçare. Sipas pretendimeve të tij, në momentin e arrestimit për shak të rinovimit të lejes së qëndrimit ishte pajisur me një dokument të përkohshëm. Oficerët e policisë e konsideruan atë të parregullt. Si pasojë është burgosur dhe gjatë qëndrimit në qeli është rrahur me shkop gome.
- **B.L. 19 vjeç banues në Durrës**, është arrestuar në brendësi të kufirit grek. Pas arrestimit është keqtrajtuar dhe mbajtur në postën policore për dy ditë dhe më pas është rikthyer në pikën kufitare të Kapshticës. Mjeku ligjor që e vizitoi konstatoi shenja dëmtimesh veçanërisht dëmtime në brinjë dhe në këmbën e djathtë.
- **I. Z. banues në fshatin Deshيران të rrethit Durrës**, gjithashtu është arrestuar, rrahur dhe deportuar nga Greqia. Ai pretendon se veshkat e tij janë dëmtuar nga (dhuna fizike që është ushtruar ndaj tij) rrahja që ka pësuar. Në momentin e mbërritjes në kufirin shqiptar të dy shfaqnin shenja të dhunes. Oficeret shqiptarë të policisë morën deklaratat e tyre.
- **V.M., banues në fshatin Plug të rrethit Lushnje** gjithashtu i është nënshtruar keqtrajtimit fizik pasi ka tentuar të kalojë kufirin në mënyrë të paligjshme.
- **A.P., banues në fshatin Kozar të rrethit Kukës** është rrahur në mënyrë brutale deri sa ka rënë pa ndjenja.
- **O. Osmani banues në rrethin e Kolonjës**, kishte punuar prej tre vitesh në zonën e Larisë dhe kishte kryer të gjitha pagesat e nevojshme për t'u pajisur me dokumenta, por ky fakt nuk është marrë në konsideratë nga policia greke. Ai është keqtrajtuar në momentin e ndalimit ashtu edhe gjatë kohës 5 ditore të qëndrimit në burg ku është ushqyer vetëm një herë dhe ka qëndruar vetëm me një bluzë verore. Është paraqitur pothuajse i zhveshur në pikën kufitare të Kapshticës dhe ka raportuar se në momentin e arrestimit policia e ka tërhequr zvarrë duke i grisur edhe rrobat. Menjëhere pas mbërritjes në pikën kufitare i është nënshtruar trajtimit të menjëhershëm në spitalin e Bilishtit.
- **19 Nëntor 2003 tre shtetas shqiptarë** janë kthyer nga autoritetet policore greke, janë arrestuar dhe madje keqtrajtuar megjithëse kishin të gjithë dokumenta të rregullt.
- **P.D, 31 vjeç nga Tirana ka punuar në Greqi** që nga viti 1994. Është ndaluar gjatë rrugës për në punë dhe është keqtrajtuar si gjatë rrugës për në pikën policore ashtu edhe gjatë kthimit në pikën kufitare duke u qëlluar me objekte të rënda që i kanë shkaktuar dëmtime në shpinë.

- **P.H. 42 vjeç nga Tirana**, ka punuar në Greqi që prej vitit 1993. Tentoi të kërkonte ndihmën e policisë pasi nuk ishte paguar nga punëdhënësi i tij për punën e kryer, por në vend të saj e rrahën dhe e mbajtën në postën e policisë për tre ditë para kthimit në Shqipëri.
- **B. P. 26 vjeç**, megjithëse me dokumenta të rregullta është ndaluar dhe mbajtur 5 ditë ku është keqtrajtuar nga policia greke dhe më pas është nxjerrë jashtë territorit grek.
- **S. Gj, 37 vjeç nga fshati Ujemisht i rrethit Kukës**, në mënyrë të ngjashme është arrestuar pas një kontradikte me punëdhënësin e tij për çështje page. Pas kthimit të detyruar në pikën doganore të Kapshticës deklaroi se ishte rrahur në stacionin e policisë. Sipas burimeve policore kishte shenja të dukshme mavijosjeje në kokë dhe pjesë të tjera të trupit.
- **26 Mars 2004, VB. 43 vjeç banues në fshatin Menkulas të rrethit të Devollit**, është arrestuar në brendësi të territorit ku kishte hyrë ilegalisht. Shpjegimet e tij se kishte hyrë (në Greqi) për të kërkuar djalin e tij 13 vjeçar të zhdukur prej disa ditësh nuk u morën parasysh nga rojet kufitarë greke. Sipas burimeve të shtypit ai është rrahur dhe është kafshuar disa herë nga një qen që ata e kishin me vete. Si pasojë i është nënshtruar kurimit në spital. Policia e Devollit konfirmoi se në momentin e rikthimit në territorin shqiptar kishte ende shenja të dhunës në fytyrë dhe në trup.
- **26 janar 2005, S. V., banues në Berzezhdha Qukës e komunës së Librazhdit** dëshironte të kalonte kufirin në mënyrë të paligjshme dhe ka vendosur në pasaportën e tij 50 Euro. Ky fakt është trajtuar si provokim nga ana e policit të kufirit i cili e ka rrahur dhe ka shkatërruar dokumentat e tij.
- **17 shkurt 2005, V. Sh.,** ka qenë emigrant, është gjykuar për kryerjen e një veprë penale dhe është dënuar me detyrim paraqitjeje dhe moslargim nga Greqia. Më 4 shtator, në kuadër të tifozërisë shqiptare, është keqtrajtuar nga një polic. V.Sh. e padit, por dy ditë para zhvillimit të gjyqit kthehet forcërisht në Shqipëri me motivimin "person i rrezikshëm dhe i padëshirueshem".
- **30 Mars 2005, K. M. vjeç 37, banues në fshatin Maminas të rrethit të Durrësit**, ka kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Është kapur nga policia dhe është goditur me objekte të forta. Ekzaminimi mjeko-ligjor evidentoi shenja dhune dhe mavijosjeje në kurriz dhe pjesë të tjera të trupit. Çështja i ka kaluar zyrës së Prokurorisë së rrethit Korçë.
- **A. Ç., 32 vjeç banues në qytetin e Laçit** ndaluar nga autoritetet policore greke për shkak të qëndrimit të tij pa dokumenta dhe është mbajtur në postën e policisë për 3 ditë, ku ka qenë viktimë e dhunës dhe keqtrajtimit.
- **7 Prill 2005, E.P, 21 vjeç dhe A. K., 17 vjeç banorë të Librazhdit**, pretenduan se janë tërhequr zvarrë në një mjet të policisë greke. Ata janë pjesë e një numri mjaft të madh emigrantësh (rreth 145 vetë) të cilët sipas të dhënave të shtypit janë riatdhesuar brenda 2 ditëve.
- **26 Korrik 2005, I. G., 19 vjeç banues në Kodrën e Danit Bulqizë**. Sipas thënieve të tij është goditur në momentin e prangosjes. Burimet policore thanë se pas mbërritjes në kufi ai ishte i traumatizuar, i uritur dhe në kushte mjaft të këqija, si pasojë e dhunës, njëri krah ishte thyer. Më pas është dërguar në spitalin e Bilishtit ku ka marrë ndihmën e nevojshme mjekësore.

Raste të ushtrimit të dhunës ndaj grave

21. Raste të përdorimit të dhunës janë shënuar edhe ndaj grave.
- **28 Tetor 2000, F. D., banuese në Tepelenë.** Gjatë kohës së ndalimit për shkak të akuzës së punësimit të paligjshëm ishte shtatzanë. Sipas pretendimeve të ngritura prej saj, F.D. është arrestuar me akuzën e punësimit të paligjshëm. Duke qëndruar në birucë, në kushte jo të mira, gjendja e saj shëndetësore keqësohet edhe për faktin se ajo që shtatzënë. Në këtë gjendje është dërguar në spital dhe atje i hiqet fëmija kundër vullnetit të saj. Në dokumentin e lëshuar nga spitali mohohej fakti se ajo kishte qenë shtatzanë dhe ndër të tjera thuhej se i ishte hequr një qese me ujë. Pas përkeqësimit të gjëndjes dërgohet në spital dhe i hiqet fëmija, veprim i cili siç pretendon ajo është kryer kundër vullnetit të saj, më pas rikthehet në birucë pa asnjë përkujdesje post operacionale.
 - **23 Nëntor 2004, K. Ç., 26 vjeç,** është gjithashtu viktimë e keqtrajtimit të policisë greke. Gjatë qëndrimit në rajonin e policisë ndaj saj është ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike. Është rrahur me grushta dhe shkelma, është privuar nga e drejta e ushqimit si për vete ashtu edhe për dy fëmijët 5 vjeç dhe 3 vjeç. Mungonin kushtet më minimale të qëndrimit, ngrohja si dhe ambientet e fjetjes. Ajo pretendonte se gjatë procesit gjyqësor nuk i është respektuar e drejta e mbrojtjes ligjore.

Plagosje e lehtë dhe e rëndë me dashje

22. Format e keqtrajtimit janë nga më të ndryshmet. Për parandalimin e këtij fenomeni Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik në 23 Korrik 2001 morën masa në mënyrë që të gjitha ankimet e emigrantëve të keqtrajtuar të evidentoheshin në formën e një deklarate të firmosur. Këto raste janë bërë prezente pranë autoriteteve greke, por me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë nuk është marrë asnjë masë.
23. Një nga shkaqet për moszbatimin e përgjegjesisë penale për autorët lidhet me klasifikimin e gabuar juridiko-penal të këtyre akteve si rrahje. Si për shkak të mosdenoncimit, ashtu edhe pamjaftueshmërisë së provave, autorët mbeten pa u ndëshkuar. Por siç do të shihet në vazhdim, ushtrimi i dhunës shpeshherë ka sjelle pasoja të tilla që duhet të klasifikohen si plagosje madje edhe plagosje e rëndë.
- **L. H., 46 vjeç, M H., 43 vjeç, banues në Zavalinë të rrethit të Elbasanit dhe R. P., i gjithashtu banues në Elbasan** janë mbajtur në mënyrë të paligjshme, janë rrahur dhe goditur me bajoneta në pjesë të ndryshme të trupit, si dhe u janë marrë sendet që u ndodheshin me vete nga rojet kufitare greke para kthimi të tyre në Kapshticë. Sipas raportit mjeko-ligjor të lëshuar në spitalin e Elbasanit, L.H. ka shfaqur dëmtim të shpretkës dhe stomakut shoqëruar me hemoragji, për pasojë i është nënshtruar një operacioni për heqjen e shpretkës.R.P. iu konstatuan brinjë të thyera.
 - **16 Dhjetor 2003, G., 43 vjeç nga Pogradeci,** është ndaluar gjatë tentativës për të kaluar kufirin grek dhe është rrahur në mënyrë çnjerëzore. Megjithëse gjendja e tij shëndetësore ishte përkeqësuar si pasojë e dhunës së ushtruar, ai është mbajtur dy netë në një stacion policie pa iu dhënë ndihma e nevojshme shëndetësore. Në pikën kufitare të Kapshticës ai është vizituar nga një mjek ligjor i cili ka konstatuar dëmtime të rënda si dhe hemoragji në organet gjenerale. Ai i është nënshtruar një operacioni në spitalin e Korçës i cili ka qenë i nevojshëm për të shpëtuar jetën e tij.

- **1 Prill 2005, A. C., 30 vjeç lindur në fshatin Radovickë të rrethit Ersekë dhe banues në Laç.** Pavarësisht shpjegimeve që u ka dhënë autoriteteve policore se ishte në pritje të lejes së qëndrimit, është qëlluar me grushta, është shkëlmuar dhe është rrahur në mënyrë brutale. Si pasojë e keqtrajtimit ka rënë në koma për 24 orë. Në momentin e transportimit të tij në pikën e kalimit të Kapshticës janë konstatuar shenja dhune në këmbë dhe në kurriz. Çështja i ka kaluar prokurorisë së rrethit Korçë.
 - **16 Prill 2005, Ç. A., 33 vjeç banues në Panaja të rrethit Vlorë,** në tentativën për të kaluar kufirin në mënyrë ilegale është kapur nga forcat policore dhe është bërë objekt i dhunës fizike. Është goditur me shkelma në bark dhe në pjesë të tjera të trupit. Gjendja shëndetësore është përkeqësuar gjatë qëndrimit në dhomat e izolimit ku ka pësuar një krizë në stomak e shoqëruar me hemoragji të brendshme. Për pasojë i është nënshtruar një operacioni të vështirë.
24. Rastet më flagrante janë ato që lidhen me përdorimin e armëve nga autoritetet policore greke.
- **4 Korrik 2001, A .S., me banim në fshatin Plangaricë, Komuna e Gracës rrethi i Elbasanit,** është qëlluar dhe si pasojë ka mbetur i paralizuar nga një plumb Sipas rojeve kufitare, pretendohet së është goditje aksidentale, rojet kufitare kanë qëlluar për paralajmërim ndaj disa shqiptarëve që tentonin të kalonin kufirin grek. Autoritetet greke kanë pohuar se "nga pikëpamja penale dhe disiplinore çështja është arkivuar".
 - **Mars 2002, F C., pensionist** është goditur dhe plagosur ndërsa tentonte të kalonte kufirin greko-shqiptar. Rasti i tij është një ndër rastet ku u tentua të vihet drejtësia në vend dhe të vihen para përgjegjësisë autorët e plagosjes së tij. Fillimisht, nga hetimi ushtarako-administrativ u konkludua se veprimi i ushtarit ishte thjesht një parregullsi për të cilin u aplikua sanksioni disiplinor prej 10 ditësh burgim duke e përjashtuar atë nga përgjegjësia penale. Pas konstatimit të një tërësie parregullsish gjatë hetimit administrativ dhe dyshimeve për përgjegjësi penale për ushtarin përgjegjës u vendos që çështja të trajtohej nga Gjykata Ushtarake e Selanikut. Më ndërhyrjen e Monitoruesit Grek të Helsinkit u bë e mundur që Ferhat Çeka të jepte dëshminë tij në 11.06.2003 duke i hapur rrugë kështu zgjerimit të hetimeve në lidhje me këtë keqtrajtim. Në shtator të vitit 2004 çështja është trajtuar në seancë gjyqësore dhe gjykata greke ka shpallur njërin prej ushtarëve grekë të pafajshëm, ndërsa ushtari tjetër u shpall i fajshëm dhe u dënua me një vit heqje lirie, e cila iu konvertua në 3 vjet lirim me kusht dhe detyrim për parqitje. Seanca gjyqësore është monitoruar nga KSHH dhe GHM të cilët kanë dalë edhe me një deklaratë për media shqiptare dhe greke.
 - **21 Prill 2002, S. M. 26 vjeç lindur në Lekbibaj Tropojë, banues në Tiranë** është qëlluar me pistoletë nga një ushtar grek në afërsi të pikës kufitare të Kapshticës. Si pasojë, i është nënshtruar një operacioni që e ka nxjerrë jashtë rrezikut për jetën.
 - **Shtator 2003, G.R, 35 vjeç banues në fshatin Mafshëz të rrethit Krujë,** është qëlluar nga ushtarët Greke dhe plagosur në krahë ndërsa përpiqej t'i shmangej policisë greke pasi kishte hyrë në territorin grek në mënyrë ilegale. Pas rikthimit të tij në territorin shqiptar ekzaminimi mjekësor i kryer pranë Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin nga Tortura dhe Trauma u gjetën shenja të hyrjes dhe daljes së një plumbi në krahun e tij të djathtë. Çështja e tij është ngritur nga Organizata Ndërkombëtare kundër Tortures.

Vepra penale kundër jetës

25. Shpeshherë dhuna ka marrë formën e saj më ekstreme duke sjellë pasoja fatale për jetën e emigrantëve shqiptarë.
- **B. Q., 23 vjeç**, ka mbetur i vrarë pas një shkëmbimi zjarri siç pretendohet nga autoritetet policore greke ndonëse arma që mendohej se ai mbante me vete nuk u gjend asnjëherë. 6 shqiptarët e tjerë që ishin me të, pretendojnë se janë keqtrajtuar për të dëshmuar se viktima ishte e armatosur. Ministria Greke e Rendit ka deklaruar se çështja është arkivuar si nga pikëpamja ligjore ashtu edhe ajo disiplinore.
 - **H.M., nga fshati Markat i rrethit Sarandë**, ka gjetur vdekjen si pasojë e një goditjeje me armë e cila siç pretendohet nga autoritetet greke, ka ardhur si pasojë e një shkëmbimi me armë zjarri midis forcave greke dhe dy shqiptarëve në tentativen për vjedhje bagëtish. Ndonëse shoqëruesi i tij u dënua për vjedhje të bagëtive dhe armëmbajtje, autori i vrasjes nuk iu nënshtroi asnjë lloj përgjegjësie me argumentimin se ka vepruar për vetëmbrojtje.
 - **22 Tetor 2003, V. B., 18 vjeç nga fshati Muc i Hasit**, i cili ka kaluar kufirin në mënyrë klandestine në kërkim të punësimit, është vrarë në afërsi të pikës së kalimit Kapshticë ndërsa përpiquej t'i shmangej arrestit. Ka të dhëna se në momentin e gjuajtjes ai kishte ndaluar së vrapuari dhe nuk paraqiste asnjë rrezik. Autoritetet raportuan se oficeri përgjegjës do të përgjigjet për veprimin e kryer sipas ligjit grek. Fillimisht ai u akuzua për "vrasje nga pakujdesia" por Këshilli i Kundravajtjeve më vonë e ndryshoi akuzën nga krim në kundravajtje. KSHH e ka ndjekur çështjen në fjalë si një nga ngjarjet më të rënda dhe u informua se asnjë nga familjarët nuk u lejua të dëshmonte para gjykatës.
26. Në jo pak raste shqiptarët kanë qënë viktima të ksenofobisë dhe shprehjeve raciste të cila t kanë sjellë si pasojë dhunën ndaj shqiptarëve, madje në disa raste edhe humbjen e jetëve të pafajshme.
- Rasti më tipik është ai i **G.P., i cili në 4 Shtator të 2004** është goditur në mënyrë vdekjeprurëse nga një qytetar grek pasi kishte demonstruar mbështetje ndaj skuadrës shiptare të futbollit, menjëherë pas zhvillimit të ndeshjes së futbollit, midis dy skuadrave kombëtare.
Ky rast është ndjekur me vëmendje të veçantë nga KSHH në bashkëpunim me Monitoruesin Grek të Helsinkit të cilët kanë reaguar në një konferencë të përbashkët për shtyp ku janë shprehur kundër vendimit të gjykatës në lidhje me gendjen psiqike të autorit të krimit dhe kanë kërkuar evidentimin e përgjegjësive për fajtorët. Për fat të keq ky rast nuk ka qënë rasti i vetëm. Në Maj të vitit 2006, është zhvilluar procesi gjyqësor i cili e ka shpallur qytetarin grek fajtor dhe gjykata greke i ka dhënë një dënim me 40 vjet burg.
 - **25 Maj 2005, A. L., 30 vjeç banues në Korçë**, është ekzekutuar pasi ka festuar ditëlindjen e tij me disa persona të tjerë. Trupi është gjetur i masakruar dhe gjysëm i zhveshur 15 km larg Athinës në një rrugë periferike. Autopsia ka evidentuar shenja të ndryshme dhune në trupin e tij. Këto shenja tregojnë se viktima ka gjetur vdekjen si pasojë e goditjes me mjete të mprehta në zverk.
 - **31 Mars 2005, K D. 29 vjeç nga Berati**, ka marrë rrugën e emigrimit në mënyrë ilegale për t'u bashkuar me të shoqen por është gjetur i vdekur në brendësi të kufirit grek nga një çoban. Ndonëse versioni i policisë greke i bazuar në ekspertizën mjeko-ligjore ishte se vdekja është shkaktuar nga një atak në zemër, familjarët nuk janë të bindur për këtë version. Ata pretendojnë se në momentin e indentifikimit viktima ka patur një gërvishtje në ballë dhe

shenja në kokë. Zbardhjen e së vërtetës ata e shohin tek personat me të cilët udhëtonte si dhe tek hetimet e autoriteteve shqiptare dhe greke.

Roli i Komitetit Shqiptar të Helsinkit në mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve shqiptarë

27. Komiteti shqiptar i Helsinkit si një Organizatë e të drejtave të njeriut ka patur në fokusin e veprimtarisë së tij edhe këtë plagë të shoqërisë shqiptare. Një ndër fushat e veprimtarisë së KSHH-së është vëzhgimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Greqi. Janë zgjedhur emigrantët shqiptarë në Greqi si objekt i veprimtarisë së KSHH-së për disa arsye:

Së pari, në Greqi është numri më i madh i emigrantëve shqiptarë.

Së dyti pasi është konstatuar se të drejtat e emigrantëve shqiptarë në greqi çënohen më shpesh.

Së treti, kontaktet më të shumta të KSHH-së kanë qenë me emigrantët shqiptarë në Greqi, si nëpërmjet ankesave dhe letrave të marra prej tyre, ashtu edhe nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme që KSHH ka realizuar në pikat e kalim-kufirit Kapshiticë dhe Kakavijë.

28. KSHH ka marrë dhe vazhdon të marrë njoftime rreth rasteve të keqtrajtimit të emigrantëve në Greqi. Nëpërmjet korrespondentëve të tij në rrethe janë marrë masat për verifikimin e letrave të ardhura në adresë të KSHH-së, nëpërmjet kontaktimit me të afërmit e viktimave apo organeve kompetente shtetërore në lidhje me trajtimin e çështjeve dhe mënyrën e procedimit të tyre.
29. KSHH ka qenë aktiv në dhënien e ekspertizave ligjore pranë Komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut në Kunvendin e Shqipërisë. KSHH ka ndjekur me interes çështjen e diskutuar mbi proceset penale të zhvilluara në Greqi ku emigrantëve shqiptarë nuk u ishte siguruar përkthim dhe kishin patur një përfaqësuese ligjore që nuk dinte gjuhë shqipe. Për këtë çështje, KSHH i ka dërguar disa herë letra Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë.
30. Për trajtimin e letrave dhe ankesave të emigrantëve shqiptarë, KSHH bashkëpunon me Monitoruesin Grek të Helsinkit (GHM) dhe me organizata të tjera të të drejtave të njeriut. Në shtator të vitit të 2004, KSHH në bashkëpunim me Monitoruesin Grek të Helsinkit ishin të pranishëm në gjyqin e zhvilluar në Sebnik-Greqi për çështjen penale e F.C kundër shtetit Grek. Monitorimi i seancës gjyqësore nga organizatat shqiptare në Greqi, ishte eksperiencia e parë për shoqërinë civile në Shqipëri. Bashkëpunim të rëndësishëm, KSHH ka patur me GHM lidhur me rastin e G. P. dhe L.B.
31. KSHH si një organizatë jo-fitimprurëse, ka luajtur rolin e saj pozitiv në sensibilizimin e autoriteteve shtetërore për problemet e shtruarra për zgjidhje dhe në vënien në vend të të drejtave të shkelura nga autoritetet Greke. Kjo gjë është realizuar me bashkëpunimin e frutshëm me GHM e cila vepron në Greqi dhe Amnesty International.
32. KSHH ka realizuar misione vëzhgimi në pikën e kalim-kufirit Kapshiticë dhe Kakavijë. Qëllimi i tyre ka qenë mbledhja e të dhënave mbi mënyrën e trajtimit të emigrantëve shqiptarë nga policia shqiptare dhe greke, evidentimi i rasteve të keqtrajtimit, mundësitë që ekzistojnë për një trajtim human dhe njerëzor të tyre në pikat e kalimit të kufirit, etj. Përveç takimeve me përfaqësues të komisarariatit Bilisht, komandantit të postës së kufirit dhe

intervistat me emigrantë shqiptarë, përfaqësues të KSHH-së kanë marrë takime me përfaqësues të Prokurorisë pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të Korçës.

33. Korrespondentët e KSHH-së në Korçë dhe Gjirokastrë, kanë realizuar vëzhgime të herëpashershme për të parë respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë gjatë kalimit të pikave të kufirit. Ata kanë qenë “të vëmendshëm” në identifikimin e rasteve të keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë dhe verifikimin e tyre.

Përfundime dhe Sugjerime

34. Nga takimet e zhvilluara, KSHH ka nxjerrë përfundime në lidhje me punën e strukturave shtetërore për trajtimin e viktimave si dhe procedimin e rasteve. Përfundimet e arritura si dhe sugjerimet përkatëse me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen janë bërë prezente në një letër dërguar Ministrisë së Brendshme.
35. Gjatë veprimtarisë së tij, Komiteti Shqiptar i Helsinkit konstaton se me gjithë përpje kjet e bëra, gjatë këtyre viteve ka patur raste të shkeljeve të të drejtave të emigrantëve shqiptarë që jetojnë e punojnë në Greqi.
36. Kthimet masive të emigrantëve shqiptarë nga policia greke në pjesën më të madhe të rasteve janë shoqëruar me shkelje të të drejtave dhe me cënim të dinjitetit të tyre.
37. Shkelje të të drejtave të tyre janë evidentuar veçanërisht në momentin e ndalimit, të arrestimit, gjatë fazës së hetimit, si dhe proceseve gjyqësore që zhvillohen ndaj shqiptarëve.
38. Nga kontaktet me emigrantët e kthyer forcërisht, autoritetet policore shqiptare si dhe prokuroritë e rretheve është konstatuar se mekanizmi i vënies para përgjegjësive së autorëve nuk ka funksionuar. Cilësimi jo i saktë mjeko-ligjor i dëmtimeve të viktimave të këqtrajtuara, pamjaftueshmëria e provave dhe në disa raste mungesa e vullnetit për të dëshmuar nga të dëmtuarit, kanë çuar në zvarritjen ose pushimin e procedimeve penale.
39. Ndonëse rastet e keqtrajtimit të emigrantëve janë evidentuar nga Policia Kufitare dhe i janë dërguar Prokurorive përkatëse, këto çështje janë diskutuar në rang bilateral, por trajtimi i tyre juridik nuk ka qënë efektive

Per sa më sipër KSHH sugjeron:

40. Marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e punës së strukturave policore shqiptare në kufi me qëllim menaxhimin më të mirë të trajtimit të emigrantëve legalë ose ilegalë që do të riatdhesohen.
41. Koordinim më të mirë të punës mes strukturave pritëse, trajtuese dhe përcjellëse me qëllim që të sigurohet mirëtrajtimi i rasteve nga pala shqiptare.
42. Në këtë kuadër, është e nevojshme që shteti të marrë masa që viktimave të keqtrajtimit t’u sigurohen të gjitha kushtet e nevojshme për pritjen e tyre, dhënien e ndihmës së parë dhe procedimin e mëtejshëm të këtyre rasteve.

43. Autoritetet shqiptare duhet të bashkëpunojnë me autoritetet greke me qëllim që të parandalohen dhe të ndëshkohen ëndë aktet raciste dhe diskriminuese ndaj emigrantëve shqiptare. Veçanërisht duhet të rritet efektiviteti i drejtësisë shqiptare në procedimin e çështjeve të kësaj natyre dhe të mbrojtjen më të mirë të viktimave që denoncojnë shkeljet në policinë ose prokurorinë shqiptare.
44. Përfaqësitë diplomatike ose konsullore në përputhje me kompetencat ligjore duhet të kenë një rol më aktiv në mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve shqiptarë. Në këtë kuadër mendojmë se duhet të rritet kontakti i përfaqësive diplomatike ose konsullore me shtetasit shqiptarë që kanë emigruar në vende të tjera. Kjo gjë do të sillte një njohje më të gjerë të problemeve të tyre dhe tek e fundit, një mbrojtje më të mirë të të drejtave të tyre. Gjithashtu mendojmë se përfaqësitë diplomatike ose konsullore duhet të jenë më të sensibilizuara ndaj emigrantëve shqiptarë, problemeve të tyre sidomos në rastet e dhunimit të të drejtave të tyre.
45. Theksojmë se kjo situatë është pasojë e mungesës së një politike të vërtetë emigracioni midis shteteve e cila nga njëra anë mund të kishte parandaluar disa forma të kriminalitetit si trafikimi i qënieve njerëzore emigracionin e paligjshëm e nga ana tjetër mund t'u kishte prerë shtegun sjelljeve ksenofobiste e diskriminuese ndaj emigrantëve që për fat të keq në disa raste shfaqen edhe brenda strukturave shtetërore.
46. Një aspekt të rëndësishëm të këtyre politikave mund të përbënin marrëveshjet e punësimit marrvëshje të tilla jo vetëm duhen shkruar, por edhe duhen zbatuar.
47. Shoqëria civile duhet të jetë aktive në sensibilizimin e publikut në lidhje me domosdoshmërinë e politikave të emigrimit me qëllim dhënien fund të fenomeneve të keqtrajtimit dhe situatave të pasigurisë për emigrantët shqiptarë, por edhe për të sensibilizuar shtetasin për të migruar në mënyrë legale dhe për të parandaluar trafikimin dhe kalimin e paligjshëm të kufijve.
48. Nga sa u trajtua më sipër emigracioni shqiptar ka një të kaluar të hidhur e lidhur me vuajtje mundime keqtrajtimit madje edhe me jetë njerëzish. Kjo duhet të na bëjë të reflektojmë për të nesërmen në mënyrë që e kaluara të mos përsëritet më.